



A.nr.203/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.203/2026, të datës 25.02.2026, të parashtruar nga ankuesi V.Ç, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1, nenin 16, paragrafi 3, si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 27.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.203/2026, e datës 23.02.2026, e parashtruar nga ankuesi V.Ç.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm administrativ në mënyrë që ankuesit t’i bëhet kompensimi retroaktiv i diferencës së pagës së ekspertit (B5-12) nga muaji shtator 2024 deri në zbatim deri në zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.08/280 të datës 19.12.2025.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi V.Ç, (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 23.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër njoftimit të datës 23.02.2026, të Divizionit për Burime Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për mos njohjen e kompensimit retroaktiv të diferencës së pagës së papaguar sipas koeficientit B6-12 dhe atë nga data muaji shtator 2024 deri në zbatimin e vendimit të Qeverisë të datës 19.12.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit më ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 988/2026 të datës 25.02.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Ref:447/2024 të datës 03.07.2024 për sistemim të përhershëm; Akt Emërimit me Nr. 133/2024 të datës 02.09.2024; Vendimin me Nr. 08/280 të datës 19.12.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Raporti i Punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike; Kërkesën e datës 18.02.2026 e parashtruar nga ankuesi tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore; Përgjigjen e datës 23.02.2026 nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore për ankuesin; Kërkesën e datës 25.11.2024 për futjen në listën e ekspertëve për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 10.03.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ***sepse:***

I. Vlerësimi i gjendjes faktike

Nga administrimi i provave të lëndë rrjedhë kjo gjendje e fakteve:

-Ankuesi sipas Vendimit Nr. Ref:447/2024, të datës 03.07.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është sistemuar në mënyrë të përhershme në pozitën Zyrtar i Lartë për IT/Divizioni për Teknologji Informative nga data 02.09.2024, e si rezultat i këtij vendimi më datë 02.09.2024 i është lëshuar Akt Emërimit me Nr. 133/2024.

-Më datë 25.11.2024, ankuesi ka parashtruar kërkesë për përfshirje në listën e ekspertëve tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, dhe ky i fundit sipas raportit të punës pozitën e ankuesit e ka përfshirë në kuadër të pozitës Ekspert sipas kategorizimit të pozitës B6, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës, më datë 19.12.2025 ka nxjerr Vendim me Nr.08/280 për aprovimin e Raportit të tretë të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike

-Ankuesi me datë 18.02.2026, i është drejtuar Udhëheqësit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me kërkesë për kompensimin në mënyrë retroaktive sipas pagës së Ekspertit B6-12 dhe atë nga muaji shtator 2024 deri në zbatimin e Vendimit me Nr. 08/280 të datës 19.12.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

- Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes emailit të datës 23.02.2026, ka njoftuar ankuesin se nga hyrja në fuqi e Vendimit me Nr. 08/280 të datës 19.12.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka filluar pagesën, si datë e miratimit të pozitës si Ekspert.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkon që të aprovohet ankesa si e bazuar, të obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ankuesit ti bëjë kompensimin retroaktiv të diferencës së pagës sipas klasës B6-12 nga data muajit shtator 2024 deri në muajin dhjetor 2025, kur është nxjerr Vendimi me Nr. 08/280 i datës 19.12.2025 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, paragrafi 1: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj",* dhe nenit 14, paragrafi 3: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nisur nga objekti i ankesës thekson faktin se më hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria e Kosovës më datë 05.02.2023 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, në fuqi nga data 06.02.2023 deri me 26.08.2024, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, Qeveria e Kosovës duke u bazuar në nenin 6 të kësaj rregullore më Vendimin Nr.07/132, të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike (tutje SSHIKS) i cili komision ka nxjerrë dy raporte lidhur me njohjen e SSHIKS dhe listën e eksperteve të miratuara sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 dhe Vendimit Nr. 09/216, të datës 14.08.2024, e sipas të cilave akte pozita e ankuesit nuk ishte njohur si pozitë e ekspertit.

Rrjedhimisht sipas Raportit të parë të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, si sisteme të informimit dhe komunikimit me rëndësi strategjike për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është aprovuar: *Sistemi Informativ i Vizave të Kosovës - SIVK Sistemi i sigurve të komunikimit digjiital (Network, DATA, VoIP & Video)* e në këtë mënyrë edhe si pozita në kuadër të listës së ekspertëve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, janë përfshitë *Udhëheqës i Divizionit të TI-së, Administrator i lart i TI-së për sisteme dhe Administrator i Sistemeve,* ndërsa, në raportin e dytë të Komisionit gjegjës nuk është njohur ndonjë pozite e re për ekspertë.

Tutje, Qeveria e Kosovës më datë 27.08.2024 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, më të cilën është shfuqizuar Rregullorja (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, ndërsa, më Vendimin 101/2230 të datës 13.11.2024, të Qeverisë së Kosovës është themeluar Komisioni i ri për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, kurse ky i fundit ka nxjerr raportin e tretë lidhur me njohjen e sistemeve të reja me rëndësi strategjike dhe rrjedhimisht bazuar në kërkesën e ankuesit të aprovuar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të datës 25.11.2024, përveç tjerash pozita e ankuesit si Zyrtar i Lartë i TI-së është miratuar si pozitë e ekspertit me klasë dhe koeficient të pagës B6, raport ky i miratuar nga Qeveria e Kosovës më Vendimin Nr.08/280, të datës 19.12.2025.

Kolegji i Këshillit sipas provave të lëndës, konstaton se ankuesi pozitën Zyrtar i lartë i TI-së, e ushtron nga data 02.09.2024, sipas Akt Emërimit me Nr. 133/2024, atëherë, referuar kuadrit ligjor si me lartë dhe meqenëse pozita e ankuesit nga organi përgjegjës dhe kompetente është përfshirë në listën e ekspertëve lidhur me Sistemet Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, kështu që, në vlerësimin e Kolegjit, e drejta e kompensimit për pozita e njohura të ekspertëve sipas Rregullores (QRK)Nr. 22/2024, rrjedhë nga data e emërimit të ankuesit në pozitën përkatëse, rrjedhimisht, mbi këtë konstatim qëndron edhe pretendimi i ankuesit për kompensimin e diferencës së pagës si ekspert nga muaji shtatori i vitit 2024 e deri në zbatimin e vendimit të Qeverisë Nr.08/280 të datës 19.12.2025, pasi që shtojca 14.4 e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, për ekspertët ka përcaktuar klasifikim të pozitës, e ndërlidhur me kompensimin retroaktive të pagës Ministra e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, më datë 31.03.2023, ka përcjell opinion të të gjitha institucionet publike lidhur me efektet e ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me c' rast sipas pikës 4 të opinionit sqarohet se: Punonjës të cilëve vet shtojca përkatëse e Ligjit, u është përcaktuar klasifikimi i posaçëm, p.sh: *ekspertë sipas shtojcës së posaçme, specialistët, inspektorët, punonjësit në arsim, shëndetësi, art, kulture e trashëgimi kulturore apo një fushë tjetër ?(vijon korrigjimi edhe në ditët dhe javët në vazhdim- pagat u barazohen retroaktivisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit).*

Andaj, theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë kompensimin e diferencës së pagës për ankuesit nga muaji shtator 2024 deri në zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.08/280 të datës 19.12.2025 dhe atë bazuar në koeficientin e përcaktuar sipas raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike dhe të miratuar me Vendimin me Nr. 08/280 të datës 19.12.2025 të Qeverisë së Kosovës.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.203/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.Ç;
- MPJD-së: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK -së;